

V E N D I M
Nr. 153, datë 22.3.2001

**PËR PROCEDURAT E OPERACIONEVE FINANCIARE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 8030,
DATË 15.11.1995 "PËR KONTRIBUTIN E SHITIT PËR FAMILJET E PASTREHA",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8647, DATË 24.7.2000**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 5 të ligjit nr. 8647, datë 24.7.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995" "Për kontributin e shtetit për familjet pastreha", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Normat e strehimit për sipërfaqet e banimit që do t'u takojnë familjeve të pastreha, të kategorisë emergjente, qiramarrëse në ish-pronë private, të jenë normat e përdorura në privatizimin e banesave shtetërore në vitin 1993, (4-6m² për frymë).

2. Për familjet e pastreha qiramarrëse në ish-pronë private, që kërkojnë të sigurojnë banesë nëpërmjet tregut të lirë, llogaritja e çmimit falas të bëhet sipas diferencës së vlerës së kostos së sotme të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave me tarifën e indeksuar sipas tabelës "Vlefë e tarifës së banesave në 000/lek" (korrigjuar me Indeks in e Korrigjimit të Çmimeve, ku klasifikimi i apartamentit të merret ndërtimi i ri (0 vjet) të udhëzimit nr. 1, datë 23.1.1993.

3. Familjet që përfitojnë banesë dhe që kërkojnë të sigurojnë banesë nëpërmjet tregut të lirë të paraqesin kërkesën me dokumentacionin përkatës pranë Entit Kombëtar të Banesave, brenda tremujorit të parë të çdo viti. Llogaritja të bëhet nga Enti Kombëtar i Banesave dhe likuidimi nga fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit. Pas likuidimit të detyrimit nga Enti Kombëtar i Banesave qytetarit i hiqet statusi i të pastrehit.

4. Për banesat e ndërtuara apo të blera në tregun e lirë nga Enti Kombëtar i Banesave, subvencioni shtetëror për familjet e pastreha, do të zbriten drejtpërdrejt nga vlera e banesës, në çastin e lidhjes së kontratës përfundimtare, ndërmjet qytetarëve dhe Entit Kombëtar të Banesave dhe do t'i njihet Entit Kombëtar të Banesave si shlyerje detyrimi ndaj buxhetit të shtetit.

5. Familjet e pastreha që kanë në përbërje të tyre invalidë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ish-partizanë, luftëtarë antifashistë, që kanë marrë pjesë në formacionet antifashiste para datës 29.11.1944, duhet të paraqesin përveç të tjerave edhe dokumentin zyrtar, të lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, ndryshuar me ligjin nr. 8526, datë 23.9.1999 "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare".

6. Organet e pushtetit vendor, nëpërmjet këshillave bashkiake ose komunave, të dërgojnë pranë Entit Kombëtar të Banesave, brenda tremujorit të parë të vitit, listën nominale të familjeve të pastreha që përfitojnë nga ligji nr. 8647, datë 23.7.2000, të cilat nuk janë trajtuar deri më sot nga Banka e Kursimeve. Listat nominale të familjeve të pastreha qiramarrëse në ish-pronë private duhet të jenë hartuar sipas përbërjes familjare dhe gjendjes së strehimit, që rezultojnë në regjistrat themeltarë të shtetasve më datë 1.12.1992.

7. Pika 1, 2, 7, 8 dhe 15 të vendimit nr. 249, datë 16.4.1996, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e operacioneve financiare për dhënie e kredive dhe të subvencioneve shtetërore, që do të kryhen nga Banka e Kursimeve, në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha" shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Enti Kombëtar i Banesave dhe organet e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta